



**FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION**

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

RAPORT I PUNËS I FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë
30.12.2025

HYRJE

Viti 2025 për Federatën e Pingpongut të Kosovës ka qenë një vit me ngarkesë të lartë aktiviteteve dhe me realizim të gjerë të programit vjetor, duke reflektuar vazhdimësi organizative, rritje të kapaciteteve dhe përfshirje të gjerë sportive. Gjatë këtij viti, Federata ka arritur të realizojë pothuajse të gjitha aktivitetet e parapara me kalendarin e saj të aprovuar, si dhe të zhvillojë një numër të konsiderueshëm aktiviteteve shtesë, veçanërisht në dimensionin ndërkombëtar.

Në këtë periudhë raportuese, FPPK ka funksionuar me 44 klube të regjistruara, mbi 600 sportistë aktivë dhe ka realizuar gjithsej 105 aktivitete sportive, organizative dhe zhvillimore. Këta tregues dëshmojnë për shtrirje të gjerë të pingpongut në nivel vendor, vazhdimësi të sistemit të garave dhe angazhim të qëndrueshëm të klubeve dhe sportistëve në të gjitha kategoritë. Po ashtu, Federata është kategorizuar e para në kategorinë C, duke konfirmuar stabilitetin institucional dhe përmbushjen e kriterëve përkatëse.

Një pjesë e rëndësishme e vitit 2025 i është kushtuar organizimit të ngjarjeve ndërkombëtare të nivelit të lartë në Kosovë, përfshirë **WTT Youth Contender Prishtina 2025** dhe **WTT Feeder Prishtina 2025**, të cilat e kanë pozicionuar vendin në kalendarin zyrtar të World Table Tennis dhe kanë kontribuar në rritjen e prezencës ndërkombëtare të pingpongut kosovar. Këto ngjarje kanë shërbyer njëkohësisht si platformë garuese për sportistët vendorë dhe si konfirmim i kapaciteteve organizative të Federatës.

Viti 2025 është karakterizuar edhe nga intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe organizimi i ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë, të cilat kanë kontribuar në rritjen e prezencës së vendit në kalendarin ndërkombëtar të pingpongut dhe në afirmimin e aftësive organizative të Federatës. Përmes këtyre aktiviteteve, pingpongu ka shërbyer jo vetëm si sport garues, por edhe si platformë bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërkombëtar.

Paralelisht me aktivitetet sportive, gjatë vitit 2025 Federata i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të kapaciteteve të brendshme dhe përgatitjes institucionale për periudhën e ardhshme. Në këtë kuadër, është zhvilluar procesi i hartimit të Strategjisë Zhvillimore 2025–2030, përmes konsultimeve dhe punëtorive me aktorët relevantë të pingpongut, duke vendosur bazën për një orientim më të strukturuar dhe të qëndrueshëm në vitet në vijim.

AKTIVITETET E BRENDSHME

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka organizuar dhe mbikëqyrur një numër të madh aktivitesh garuese në nivel vendor, duke mbuluar të gjitha grupmoshat dhe kategoritë e garimit. Aktivitetet e brendshme janë zhvilluar në përputhje me kalendarin e aprovuar vjetor dhe kanë siguruar funksionim të rregullt të sistemit të garave, vazhdimësi konkurruese dhe përfshirje të gjerë të klubeve dhe sportistëve.

Megjithatë, zhvillimi i mëtejshëm i aktiviteteve vazhdon të ndikohet nga infrastruktura aktuale e pingpongut në Kosovë, e cila në shumë raste nuk përmbush standardet bashkëkohore për stërvitje dhe gara. Objektet ekzistuese kërkojnë investime në përmirësimin e sallave, pajisjeve dhe kushteve teknike, gjë që do të mundësonte rritje të cilësisë së stërvitjeve dhe organizim më efikas të aktiviteteve sportive.

Kampionatet individuale të Kosovës

Gjatë vitit 2025 janë organizuar kampionatet individuale të Kosovës në këto kategori dhe data:

- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për U9 dhe U13** – Ferizaj, 16.03.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për Seniorë** – Ferizaj, 22–23.03.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për U21** – Ferizaj, 29.03.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për U17** – Ferizaj, 06.04.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për U11 dhe U15** – Pejë, 13.04.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për U19** – Ferizaj, 23.02.2025
- ❖ **Kampionati Individual i Kosovës për Veteranë** – Ferizaj, 06.07.2025

Këto kampionate kanë përbërë bazën kryesore të garimit individual në nivel kombëtar dhe kanë shërbyer për identifikimin e sportistëve më të suksesshëm në secilën kategori.

Garat ekipore dhe ligat kombëtare

Në vitin 2025 janë zhvilluar garat ekipore në kuadër të:

- ❖ **Superliga e Kosovës – Meshkuj** (sistemi vajtje–ardhje)
- ❖ **Superliga e Kosovës – Femra** (sistemi vajtje–ardhje)
- ❖ **Liga e Parë e Kosovës - Meshkujt** (në formë të turneut)
- ❖ **Liga e Parë e Kosovës - Femrat** (në formë të turneut)
- ❖ **Liga e Dytë e Kosovës** (fazat e rregullta në formë të turneut dhe playoff)

❖ **Liga u15 e Kosovës - Meshkujt (në formë të turneut)**

Ndeshjet e fundit të Superligës së meshkujve janë zhvilluar më 01–02.11.2025, ndërsa titulli në konkurrencën e femrave është siguruar pas ndeshjes përfundimtare të zhvilluar më 18.10.2025 në Prishtinë. Playoff-i i Ligës së Dytë është zhvilluar në Skenderaj dhe Ferizaj gjatë muajit nëntor 2025.

Kampion i Superligës së meshkujve u shpall KPP Lidhja e Prizrenit, kurse në konkurrencën e femrave triumfoi KPP Drita F. Në ligën e parë të meshkujve fitoi KPP Bashkimi ndërsa në ligën e parë të femrave kampione doli KPP Liria.

Te meshkujt në ligën e dytë A vendin e parë e zuri KPP Ponte Prizreni ndërsa në ligën e dytë B KPP Ulpiana, kurse KPP Istogu kryesoi në fund ligën e dytë C.

Turnetë TOP 8

Gjatë vitit janë organizuar turnetë përfundimtare **TOP 8**, si fazë elitare e garimit individual, në këto kategori:

- ❖ **TOP 8 U11** – Prishtinë, 11.10.2025
- ❖ **TOP 8 U13** – Ferizaj, 15.11.2025
- ❖ **TOP 8 U15** – Ferizaj, 16.11.2025
- ❖ **TOP 8 U17** – Prishtinë, 26.10.2025
- ❖ **TOP 8 U19** – Ferizaj, 08.11.2025
- ❖ **TOP 8 U21** – Ferizaj, 16.11.2025
- ❖ **TOP 8 Seniorë** – Ferizaj, 30.11.2025

Këto turne kanë mbledhur sportistët më të mirë të sezonit dhe kanë shërbyer si përmbyllje konkurruese e vitit garues në nivel individual.

Kupa e Kosovës

- **Kupa e Kosovës 2025** – Prishtinë, 22.12.2025

Kupa e Kosovës është zhvilluar në kategoritë Seniorë meshkuj, Seniore femra dhe U15, duke shënuar aktivitetin përmbyllës të sezonit garues 2025.

Turnetë tradicionale dhe memoriale

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar edhe këto turne tradicionale dhe memoriale:

- ❖ **Turneu “Dita e Pavarësisë”** – Junik, 16.02.2025
- ❖ **Turneu Memorial “Adem Jashari”** – Skenderaj, 08.03.2025
- ❖ **Turneu Memorial “Ahmet Hoxha” (U15 & Seniorë)** – Ferizaj, 18.05.2025
- ❖ **Turneu Memorial “Ahmet Hoxha” (U19 & Veteranë)** – Ferizaj, 17.05.2025
- ❖ **Turneu Memorial i Veteranëve “Dr. Fatmir Fazlija”** – Skenderaj, 14.06.2025
- ❖ **Turneu për Ditën e Çlirimit të Kosovës** – Ferizaj, 29.06.2025
- ❖ **Turneu tradicional për Seniorë – Dita e Flamurit** – Ferizaj, 29.11.2025
- ❖ **Turneu tradicional për Veteranë – Dita e Flamurit** – Ferizaj, 29.11.2025

Garat e përbashkëta Kosovë – Shqipëri

22–23 nëntor 2025, Elbasan

Në Pallatin e Sporteve në Elbasan u mbajt Kampionati Ekipor dhe Individual Kosovë–Shqipëri, në kuadër të Ligës mbarëkombëtare të pingpongut. Kampionati ekipor u organizua në formë të ligës së përbashkët, me pjesëmarrjen e dy klubeve më të mira nga secili shtet në të dy gjinitë, sipas sistemit Round Robin, për përcaktimin e kampionit ekipor Kosovë–Shqipëri.

Po ashtu, u zhvillua edhe kampionati individual i seniorëve, ku morën pjesë nga tetë lojtarë më të mirë të secilit shtet në të dy gjinitë, fillimisht në fazën e grupeve dhe më pas në shortin kryesor. Aktiviteti konfirmoi nivel të lartë konkurrues dhe theksoi bashkëpunimin e vazhdueshëm sportiv mes dy federatave.

Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvilluan edhe takime zyrtare mes përfaqësuesve të Federatës së Pingpongut të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, duke riafirmuar gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e përbashkët të pingpongut.

ORGANIZIMI I NGJARJEVE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka realizuar me sukses organizimin dhe bashkëorganizimin e disa ngjarjeve ndërkombëtare me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe afirmimin e pingpongut në Kosovë. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e prezencës së Kosovës në kalendarin ndërkombëtar të pingpongut, në përmirësimin e standardeve organizative dhe në forcimin e bashkëpunimit me organizata dhe federata partnere.

WTT Youth Contender Prishtina 2025

(29 maj – 1 qershor 2025)

Nga data 29 maj deri më 1 qershor 2025, Prishtina ishte nikoqire e garës **WTT Youth Contender Prishtina 2025**, një nga ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare për të rinj në pingpong. Për katër ditë me radhë, Pallati i Rinisë dhe Sporteve u shndërrua në epiqendër të pingpongut botëror për kategoritë e reja.

Organizimi i kësaj gare u realizua në përputhje me standardet e World Table Tennis, duke siguruar kushte profesionale për garim, akomodim dhe zhvillim të ndeshjeve.

Edhe gjatë këtij edicioni nuk mungoi pjesëmarrja e sportistëve nga vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën, çka e ktheu ngjarjen edhe në një platformë bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërkombëtar përmes sportit. Përfaqësuesit vendorë patën mundësi të garojnë përballë sportistëve të nivelit të lartë ndërkombëtar, duke fituar përvojë të vlefshme konkurruese.

WTT Feeder Prishtina 2025

(3 – 7 qershor 2025)

Menjëherë pas përfundimit të WTT Youth Contender, Federata organizoi **WTT Feeder Prishtina 2025**, e mbajtur nga 3 deri më 7 qershor 2025. Kjo ngjarje përfaqëson nivelin elitare të garave të World Table Tennis dhe ka sjellë në kryeqytet sportistë profesionistë nga vende të ndryshme të botës.

Gara u zhvillua për pesë ditë rresht në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve dhe u përcoll drejtpërdrejt përmes platformave zyrtare të WTT, duke rritur dukshëm ekspozimin ndërkombëtar të Kosovës si vend organizator. Përveç pjesëmarrjes së sportistëve të njohur botërorë, edhe pingpongistët kosovarë u përfshinë në garë, duke treguar paraqitje konkurruese dhe progres në raport me standardet ndërkombëtare.

Në kuadër të WTT Feeder Prishtina 2025, u organizua edhe një bashkëbisedim i hapur me një nga sportistët elitarë të pingpongut botëror, Simon Gauzy, i cili ndau përvojën e tij profesionale me sportistët e rinj vendorë. Ky aktivitet shërbeu si element edukativ dhe motivues për gjeneratat e reja, duke kontribuar në transferimin e përvojës dhe në rritjen e interesimit për pingpongun në nivel elitar.

Organizimi i WTT Feeder Prishtina 2025 përbën aktivitetin e dytë në kuadër të marrëveshjes pesëvjeçare të nënshkruar ndërmjet FPPK-së dhe World Table Tennis, e cila parasheh organizimin e rregullt të garave të këtij niveli në Kosovë.

Prishtina Open 2025

(20 – 22 qershor 2025)

Në periudhën 20–22 qershor 2025, në Prishtinë u zhvillua edicioni i tretë i turneut ndërkombëtar **Prishtina Open 2025**, i organizuar nga KPP Priping dhe i asistuar nga Federata e Pingpongut të Kosovës. FPPK ofroi mbështetje institucionale dhe teknike përmes sigurimit të pajisjeve profesionale, gjyqtarëve, si dhe përkrahjes organizative dhe promovuese, ndërsa menaxhimi operativ i ngjarjes u realizua nga klubi organizator.

Turneu mbledhi rreth 275 lojtarë nga 24 shtete, të cilët garuan në grupmoshat U11, U13, U19, Seniorë dhe Veteranë, në të dy gjinitë. Me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare dhe organizim të qëndrueshëm, Prishtina Open 2025 ka vazhduar të afirmohet si një turne tradicional me interes të shtuar në nivel evropian, duke kontribuar në promovimin e Kosovës si destinacion sportiv.

Vlerësim i përgjithshëm

Organizimi i këtyre ngjarjeve ndërkombëtare gjatë vitit 2025 ka dëshmuar aftësinë e Federatës së Pingpongut të Kosovës për të përmbushur standarde të larta organizative dhe për të menaxhuar me sukses aktivitete komplekse me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare. Këto aktivitete kanë krijuar përfitime të drejtpërdrejta për sportistët vendorë, kanë rritur dukshmërinë e pingpongut kosovar dhe kanë forcuar pozicionin e Kosovës në strukturat ndërkombëtare të pingpongut.

PJESËMARRJA NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm aktivitetesh ndërkombëtare, duke përfaqësuar Kosovën në gara botërore, evropiane dhe rajonale. Këto pjesëmarrje kanë përfshirë sportistë të grupmoshave të ndryshme, nga kategoritë e reja deri te seniorët, si dhe trajnerë, zyrtarë dhe gjyqtarë, duke kontribuar në rritjen e përvojës konkurruese dhe afirmimin e pingpongut kosovar në arenën ndërkombëtare.

Gara botërore dhe turne ndërkombëtare (WTT & Open)

- ❖ **International Transalpine Trophy & Mediterranean Cup 2025** – Bardonecchia, Itali (08–10.08.2025)

Përfaqësuesja e Kosovës u rendit në vendin e 5-të nga 31 shtete pjesëmarrëse, ndërsa në garat individuale u fitua medalja e bronzit nga Imran Duraki, duke dëshmuar progres të vazhdueshëm në nivel ndërkombëtar.

- ❖ **WTT Youth Contender Podgorica 2025**

Sportisti Denat Makolli realizoi një paraqitje shumë të suksesshme, duke u kualifikuar në finale të kategorisë U11 dhe duke u kthyer me trofe, çka përbën një arritje të rëndësishme për pingpongun kosovar.

Lojërat evropiane dhe kampionate kontinentale

- ❖ **EYOF Shkupi 2025** – Shkup, Maqedonia e Veriut (20–26.07.2025)

Kosova u përfaqësua në pingpong me sportistë Amant Sejdiu dhe Jona Hashani si dhe trajnerin Ardian Lamaxhema, të cilët zhvilluan ndeshje konkurruese dhe fituan përvojë të rëndësishme në një ngjarje multi-sportive të nivelit evropian.

Kampionatet ballkanike

- ❖ **Kampionati Ballkanik për Seniorë** – Stamboll, Turqi (03–07.09.2025)

Përfaqësuesja e Kosovës mori pjesë me ekipet e femrave dhe meshkujve, të shoqëruar nga stafi teknik dhe zyrtar, duke konkurruar përballë përfaqësueseve të rajonit.

- ❖ **Kampionati Ballkanik për të Rinj (U19/U15)** – Orestiada, Greqi (24–28.06.2025)

Sportistët kosovarë shënuan paraqitje solide, ku Andis Qeku dhe Rejan Krasniqi kaluan fazën e grupeve në kategoritë përkatëse. Në konkurrencën e vajzave, përfaqësuesja e Kosovës shënoi fitore ekipore, ndërsa Lenë Osmani realizoi dy fitore individuale.

❖ **Kampionati Ballkanik U11 & U13** – Albena, Bullgari (maj 2025)

Në këtë kampionat, Denat Makolli arriti fitore në fazën e grupeve në kategorinë U11, ndërsa Rejan Krasniqi dhe Olti Behluli shënuan fitore individuale në kategorinë U13.

[Turne rajonale dhe përfaqësime të klubeve](#)

❖ **Turneu Memorial “Ilija Kareski”** – Maqedonia e Veriut (22.02.2025)

Klubi KVPP Prizreni shënoi sukses të plotë në këtë turne, ku Imran Duraki u shpall kampion në kategorinë U13, ndërsa Muhammed Mudut fitoi vendin e parë në kategorinë U15, duke përfaqësuar Kosovën me sukses.

❖ **Herceg Novi Open 2025** – Herceg Novi / Igalo, Mali i Zi

Në këtë turne ndërkombëtar, sportistët kosovarë shënuan rezultate të rëndësishme në kategoritë e reja. Denat Makolli u shpall kampion në kategorinë U11, ndërsa Atlid Hajdari arriti vendin e tretë në të njëjtën kategori.

❖ **Podgorica Open 2025** – Podgoricë, Mali i Zi (01–02.02.2025)

Sportistët kosovarë shënuan rezultate të dalluara në këtë turne rajonal, ku Denat Makolli fitoi vendin e parë në kategorinë U11, Deti Konushevci vendin e tretë në U11, ndërsa Lenë Osmani arriti vendin e dytë në kategorinë U19 për femra.

❖ **Zegin Open 2025** – Borovo, Maqedoni (12–14.09.2025)

Në këtë turne ndërkombëtar, sportistët kosovarë fituan disa medalje në kategori të ndryshme, duke përfshirë vende të para, të dyta dhe të treta, dhe duke e përmbyllur turneun me rezultate të kënaqshme.

NGRITJA E KAPACITETEVE DHE MASOVIZIMI

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka realizuar një sërë aktivitete të orientuara në ngritjen e kapaciteteve sportive dhe organizative, përmirësimin e cilësisë si dhe në masovizimin e pingpongut, me fokus të veçantë te gjeneratat e reja.

Këto aktivitete kanë pasur për qëllim përmirësimin e cilësisë së punës me sportistët, forcimin e përgatitjes teknike dhe krijimin e një baze të qëndrueshme zhvillimi për të ardhmen.

Përfaqësuesja e Kosovës në pingpong

Gjatë vitit 2025, Përfaqësuesja e Kosovës në pingpong ka funksionuar me intensitet të lartë, me fokus në ngritjen e nivelit konkurrues të ekipit kombëtar, identifikimin e talenteve dhe përgatitjen e vazhdueshme fizike, teknike dhe taktike të sportistëve. Nën udhëheqjen e Drejtorit të Përfaqësueses, aktivitetet janë orientuar në organizimin e grumbullimeve të rregullta, pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare dhe forcimin e bashkëpunimit me klubet në nivel vendor.

Në këtë kuadër, gjatë vitit janë realizuar gjashtë grumbullime/kampe kryesore në vend, të dizajnuara për kategori të ndryshme dhe për objektiva specifike përgatitore:

- Grumbullimi 1 – “Elita e Pingpongut Kosovar” (Ferizaj, 06.04.2025): stërvitje e përbashkët dhe diskutim i objektivave zhvillimore, me përkushtim dhe disiplinë të lartë.
- Grumbullimi 2 – Përgatitje për Kampionatin Ballkanik U15/U19 (Ferizaj, 14–15.06.2025): 15 lojtarë U15/U19; seanca teknike/taktike dhe testime praktike; koordinim profesional i stafit teknik.
- Grumbullimi 3 – Përgatitje profesionale (Ferizaj, 15–21.07.2025): dy grupe (të rinj dhe të avancuar) me seanca intensive teknike, taktike, fizike dhe psikologjike; përdorim i sparring-ut dhe punë me trajnerë të ndryshëm.
- Grumbullimi 4 – Përgatitje profesionale me lojtarë ndërkombëtarë (Ferizaj, 09–13.08.2025): pjesëmarrje e sportistëve nga Kosova dhe shqiptarë nga diaspora; rritje e intensitetit dhe standardeve të punës, me disiplinë të lartë.
- Grumbullimi 5 – Përgatitje e gjeneratës së re (Prishtinë, 29–31.10.2025): 25 lojtarë, 3 trajnerë dhe 4 sparring-partnerë; 5 seanca intensive dhe analiza individuale të performancës.
- Grumbullimi 6 – Kamp me ekspertin nga Sllovenia (Ferizaj, 11–14.12.2025): 4 seanca intensive nën udhëheqjen e trajneres Andreja Ojstersek; metodologji e avancuar dhe efekt motivues për sportistët dhe trajnerët vendorë.

Përmes këtyre grumbullimeve, Federata ka synuar edhe ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve vendorë, përmes bashkëpunimit praktik në terren, ndarjes së rolit në seanca, si dhe ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj metodave të punës së trajnerëve të jashtëm. Kjo qasje ka kontribuar në unifikimin e standardeve të punës me sportistët dhe në rritjen e cilësisë së përgatitjeve për gara.

Përkundër angazhimit të vazhdueshëm në organizimin e grumbullimeve dhe aktiviteteve zhvillimore, duhet thënë se progresi i mëtejshëm i sportistëve është ndikuar nga kufizimet në kohën dhe intensitetin e stërvitjeve, si dhe nga mundësitë e kufizuara për pjesëmarrje në kampe elitare jashtë vendit.

Sfiduese ka mbetur edhe angazhimi i një trajneri ndërkombëtar, faktor i rëndësishëm për avancimin teknik të sportistëve dhe trajnerëve vendorë. Në këtë drejtim, Federata ka identifikuar si prioritet rritjen e numrit të grumbullimeve brenda vendit, bashkëpunimin me trajnerë ndërkombëtarë dhe përfshirjen më të madhe në kampe rajonale dhe ndërkombëtare zhvillimore.

Në aspektin e pjesëmarrjes ndërkombëtare, Përfaqësuesja ka qenë aktive në ngjarje të rëndësishme të kalendarit ndërkombëtar dhe rajonal, përfshirë WTT Youth Contender & WTT Feeder Prishtina (29.05–07.06.2025), Kampionatin Ballkanik U15/U19 në Orestiada (23–28.06.2025), Kampionatin Ballkanik të Seniorëve në Stamboll (03–07.09.2025), si dhe Kampionatin U11–U13 në Albena (20–25.05.2025). Pjesëmarrjet kanë shërbyer si test real i progresit dhe si bazë për përcaktimin e nevojave të mëtejshme të përgatitjes.

Një element i rëndësishëm i vitit 2025 ka qenë bashkëpunimi më i strukturuar me klubet. Drejtori i Përfaqësueses, së bashku me Ndihmës Drejtorin, kanë realizuar vizita dhe takime në terren në pothuajse të gjitha klubet, me qëllim vlerësimin e kushteve të punës, identifikimin e talenteve dhe koordinimin e programeve të përgatitjes.

Vizitat janë realizuar përgjatë periudhës prill–dhjetor 2025, duke përfshirë (ndër të tjera) klubet në Prizren, Ferizaj, Pejë, Prishtinë, Ulpianë, Shpresë dhe Istog. Në vitet në vijim, Federata synon të thellojë bashkëpunimin ndërmjet Përfaqësueses dhe klubeve përmes planeve të përbashkëta të zhvillimit, seleksionimeve të rregullta dhe monitorimit të vazhdueshëm të progresit të sportistëve.

Aktivitetet për masovizimin e pingpongut

Në kuadër të promovimit dhe shtrirjes së pingpongut në komunitet, gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitete me karakter edukativ dhe argëtues, të orientuara kryesisht drejt fëmijëve dhe të rinjve.

- **Pingpong në shkolla** - Një hap pozitiv në drejtim të masivizimit është përfshirja e pingpongut në programin “Sporti në Shkolla” të MKRS-së. Ky vit ishte si pilotprojekt i sportit të pingpongut në kuadër të Federatës së Sportit Shkollor ku janë të përfshira shtatë regjione të Kosovës. Aktualisht janë shtatë mësime (trajner) në shtatë shkolla, me mbi 250 nxënës të përfshirë. Federata synon përfshirjen e sportit të pingpongut në së paku 25 shkolla deri në vitin 2030, përmes bashkëpunimit me MKRS-në, komunat dhe drejtoritë arsimore.
- **Aktiviteti për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve (1 Qershor) – Prishtinë**
Në bashkëpunim me klubet vendore dhe institucionet komunale, FPPK organizoi një aktivitet promovues në sheshin “Skënderbeu”, ku fëmijët patën mundësi të njihen me pingpongun dhe të marrin pjesë në aktivitete rekreative.

Mbështetja dhe shpërblimi i sportistëve

Në kuadër të përkrahjes së talenteve të reja dhe vlerësimit të rezultateve të arritura në arenën ndërkombëtare, Federata e Pingpongut të Kosovës gjatë vitit 2025 ka ndërmarrë masa konkrete për motivimin dhe mbështetjen e sportistëve më të dalluar.

- Imran Duraki është shpërblyer nga Federata e Pingpongut të Kosovës për rezultatet e tij të shkëlqyera në International Transalpine Trophy & Mediterranean Cup 2025, ku ai zuri vendin e tretë. Vendimi për shpërblim është marrë nga Bordi i FPPK-së më 3 shtator 2025, ndërsa shpërblimi është realizuar përmes pajisjeve sportive dhe mbështetjes financiare.
- FPPK-ja e ka njohur dhe vlerësuar suksesin e Denat Makollit në WTT Youth Contender Podgorica 2025 të cilin edhe e ka mbështetur përmes pajisjeve sportive.
- Shega Hashani dhe Blend Hajdari janë përzgjedhur si përfitues të bursës “Shpresa Olimpike 2025”, në kuadër të programit mbështetës të Komitetit Olimpik të Kosovës për sportistët e rinj me potencial të lartë.
- Për vitin 2026, 5 sportistë (Lene Osmani, Akil Mahmuti, Andis Qeku, Shega Hashani dhe Taibe Ruli) janë përfshirë në bursë duke e ngritur numrin e përfituesve në raport me vitet e kaluara, ku çdo vit paraprak janë mbështetur nga dy sportistë.
- Gjatë vitit 2026, synohet arritja e përfitimit nga skema super-sportisti, me së paku një sportist të pingpongut dhe trajner.

Këto masa përfaqësojnë pjesë të politikave të Federatës për motivimin e sportistëve, njohjen e rezultateve të arritura dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm sportiv.

Përveç fokusit te sportistët, gjatë vitit 2025 janë shënuar edhe aktivitete që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve të trajnerëve dhe stafit sportiv, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së punës në nivel vendor.

ARBITRIMI

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të arbitrimit dhe ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, duke e konsideruar këtë segment si element kyç për rritjen e cilësisë së garave dhe për përfaqësimin dinjitoz të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Arritje në nivel ndërkombëtar

Një nga arritjet më të rëndësishme në fushën e arbitrimit gjatë vitit 2025 është avancimi profesional i Naim Azemit, i cili ka përbushur kushtet për titullin Blue Badge, duke u vlerësuar maksimalisht në kuadër të procesit ndërkombëtar të vlerësimit. Ky proces, i cili përfshiu edhe vlerësimet gjatë Kampionatit Evropian për të Rinj në Ostrava (11–20 korrik 2025), u përmbyll me sukses në fillim të vitit 2026 në Francë, me që rast vetëm dy gjyqtarë arritën titullin Blue Badge nga gjithsej 12 kandidatë, duke konfirmuar nivel të lartë profesionalizmi dhe kompetence në gjykimin ndërkombëtar.

Trajnimi dhe licencimi i gjyqtarëve vendorë

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të arbitrimit vendor, më **16.08.2025**, në Sallën e Konferencave të Shtëpisë së Sporteve, janë organizuar **dy seminare** për gjyqtarët e Federatës së Pingpongut të Kosovës. Seminari i parë ishte i dedikuar për gjyqtarët aktualë, ndërsa seminari i dytë për gjyqtarët e rinj.

Në këto seminare janë trajtuar:

- rregullat e përgjithshme dhe të reja të pingpongut,
- kompetencat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve,
- gabimet e shpeshta në gjykim dhe mënyrat e evitimit të tyre,
- standardet e kryerjes së detyrave gjatë garave.

Pas përfundimit të seminarit për gjyqtarët e rinj, është realizuar testimi teorik për licencimin e tyre si gjyqtarë kombëtarë, duke kontribuar në zgjerimin dhe forcimin e bazës së arbitrimit vendor.

QEVERISJA DHE MENAXHIMI

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka funksionuar në përputhje me Statutin e saj, Ligjin për Sport dhe aktet nënligjore në fuqi, duke siguruar ushtrimin e rregullt të kompetencave të organeve drejtuese dhe një menaxhim të qëndrueshëm institucional. Vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit të qeverisjes së brendshme, transparencës në vendimmarrje dhe përfshirjes së akterëve relevantë në proceset kyçe.

Kuvendi i rregullt dhe zgjedhor

Më 31.01.2025 është mbajtur Kuvendi i rregullt dhe Kuvendi zgjedhor i Federatës së Pingpongut të Kosovës, me pjesëmarrjen e 43 delegatëve nga klubet anëtare, të gjithë me të drejtë vote, si dhe përfaqësuesve të institucioneve relevante. Kuvendi u zhvillua në përputhje me procedurat statutores dhe rendin e ditës së aprovuar.

Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës dhe prezantimit të programeve nga kandidatët për kryetar, procesi zgjedhor u realizua përmes votimit të fshehtë. Si rezultat i votimit, Jeton Oruçi u zgjodh Kryetar i Federatës së Pingpongut të Kosovës, ndërsa u zgjodh edhe përbërja e re e Bordit Ekzekutiv, duke siguruar vazhdimësinë e funksionimit të organeve drejtuese të Federatës.

Bordi Ekzekutiv dhe strukturat drejtuese

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, Federata ka funksionuar me një Bord Ekzekutiv të përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, si dhe nga anëtarët e propozuar në përputhje me Statutin.

Bordi Ekzekutiv ka ushtruar rolin e tij në drejtimin strategjik, miratimin e vendimeve operative dhe mbikëqyrjen e zbatimit të aktiviteteve gjatë vitit 2025.

Në kuadër të funksionimit të strukturave drejtuese, Kryetari i Federatës ka propozuar emërimin e nënkryetarit dhe anëtarëve shtesë të Bordit Ekzekutiv, duke kompletuar strukturën drejtuese për mandatin e ri.

Përgjatë vitit, një pozitë e anëtarit të Bordit Ekzekutiv ka mbetur vakant si rrjedhojë e dorëheqjes së paravokueshme të z. Besim Hajdarit, e cila pozitë do të plotësohet në përputhje me procedurën e përcaktuar me Statutin e Federatës.

Organogrami i Federatës është hartuar me qëllim të përcaktimit të qartë të shtyllave të zhvillimit kryesore të zhvillimit, duke synuar lehtësimin e zbatimit të Strategjisë Zhvillimore të Pingpongut. Ndryshimet statutores që pritet të bëhen në Kuvendin e rregullt të punës të vitit

2026, i hapin rrugë Bordit Ekzekutiv të Federatës për hartimin e Rregullores për procedurat dhe aspektet organizative të Federatës. Kjo rregullore, do të përcaktojë në mënyrë të qartë linjat e përgjegjësisë së anëtarëve të Bordit, stafit administrativ, anëtarëve të komisioneve si dhe aspektet tjera të qeverisjes,

Krijimi i Komisionit të Sportistëve

Në pajtim me Ligjin e ri për Sport, gjatë vitit 2025 Federata e Pingpongut e Kosovës ka krijuar Komisionin e Sportistëve, përmes një procesi zgjedhor të drejtpërdrejtë dhe demokratik. Zgjedhjet për këtë komision janë mbajtur më 23.03.2025, ku sportistët i dhanë besimin përfaqësuesve të tyre. Shëga Hashani është zgjedhur kryesuese e këtij komisioni e një heresh edhe anëtare e bordit ekzekutiv.

Krijimi i Komisionit të Sportistëve ka për qëllim përfaqësimin e interesave të sportistëve në proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në strukturat drejtuese të Federatës, përfshirë edhe pjesëmarrjen në Bordin Ekzekutiv, në përputhje me aktet normative në fuqi.

Punëtoritë dhe procesi konsultativ

Bordi aktual, ka arritur të ndryshoj rrënjësisht mënyrën e punës me anëtarët e saj. Gjatë vitit 2025 janë organizuar punëtori me karakter zhvillimor dhe konsultativ, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të klubeve, trajnerëve dhe strukturave drejtuese të Federatës, me qëllimin e vetëm zhvillimin dhe avancimin e punës së Federatës.

Punëtorja zhvillimore e mbajtur në Shëngjin (29–31 gusht 2025) u fokusua në çështje të qeverisjes së mirë, organizimit të garave, bashkëpunimit rajonal, qasjes strategjike dhe zhvillimit afatmesëm të pingpongut.

Punëtorja e dytë e mbajtur më 27.12.2025 shërbeu për reflektim mbi aktivitetet e realizuara gjatë vitit, diskutimin e kalendarit të garave për vitin pasues, shqyrtimin e ndryshimeve të planifikuara në aktet normative dhe draftin e strategjise për zhvillimin e pingpongut 2025-2030.

Këto punëtori kanë shërbyer si platformë për shkëmbim mendimesh dhe përfshirje të klubeve në proceset planifikuese dhe zhvillimore. Si rrjedhojë e këtyre punëtorive të mbajtura, Kalendar i garave për vitin 2026 është ri-organizuar duke e bërë një racionalizim të aktiviteteve për vitin 2026. Racionalizimi i aktiviteteve do të krijojë mundësi të reja për Federatën dhe klubet që të ngrisin kapacitetet organizative të garave si dhe të ofrojë mundësi më të mira për

sportistët dhe trajnerët që të kenë më shumë kohë në dispozicion për ngritjen e performancës së tyre në gara.

Paralelisht me këto ndryshime, viti 2026 do të ofroj mundësi më të mëdha për shpërfaqjen e gjeneratave të reja dhe talentit të tyre, duke organizuar gara tek grupmoshat e reja, si dhe mundësuar pjesëmarrjen më të madhe të tyre në aktivitetet e Federatës. Fokusi kryesor i Federatës janë investimi në potencialin e gjeneratave të reja për ngritjen e nivelit të Pingpongut në periudhë afatmesme.

Ngritja e kapaciteteve profesionale

Tanimë kapacitetet administrative të Federatës janë shtuar duke angazhuar staf shtesë. Tani FPPK ka gjithsej 7 të angazhuar me marrëdhënie pune sipas kërkesave ligjore të Ligjit të Punës.

Gjatë vitit 2025, Federata ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes programeve të avancuara të menaxhimit sportiv në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Akademinë Olimpikë të Kosovës.

Po ashtu, në dhjetor 2025 është shtuar pozita e Ekspertit për Hartimin e Politikave dhe Projekteve Zhvillimore, me qëllim forcimin e kapaciteteve organizative dhe mbështetjen e zhvillimit afatgjatë të Federatës.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut të Kosovës ka intensifikuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet institucionale, me synim avancimin e pingpongut kosovar, forcimin e kapaciteteve organizative dhe rritjen e përfaqësimit të Kosovës në strukturat evropiane dhe botërore të pingpongut. Këto bashkëpunime kanë krijuar bazë për projekte të reja zhvillimore dhe për pjesëmarrje më aktive në programe ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me federatat ndërkombëtare (ITTF dhe ETTU)

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar takime zyrtare me përfaqësues të **Federatës Ndërkombëtare të Pingpongut (ITTF)** dhe **Unionit Evropian të Pingpongut (ETTU)**, me qëllim thellimin e bashkëpunimit dhe eksplorimin e mundësive të reja për zhvillimin e pingpongut në Kosovë.

Në takimet me përfaqësuesit e ITTF-së janë diskutuar çështje që lidhen me:

- përfshirjen e Federatës në programe dhe skema financimi,
- mundësitë për zhvillimin e kapaciteteve për sportistë, trajnerë dhe gjyqtarë,
- avancimin e praktikave të qeverisjes dhe digjitalizimit,
- organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare dhe përgatitjet afatgjata për garat multi-sportive.

Po ashtu, në kuadër të takimeve me ETTU-në, është diskutuar identifikimi i programeve zhvillimore për periudhën e ardhshme, përfshirë projekte të dedikuara për trajnerë dhe gjyqtarë, si dhe iniciimi i procedurave për përfshirjen e turneut ndërkombëtar **“Prishtina Open”** në kalendarin zyrtar të ETTU-së, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe nivelit konkurrues.

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut e Kosovës ka qenë e përfaqësuar në nivelet më të larta të vendimmarrjes ndërkombëtare. Kryetari i Federatës mori pjesë në Kongresin e Federatës Ndërkombëtare të Pingpongut (ITTF) të mbajtur në Doha, Katar, ku u rizgjodh Presidentja Petra Sörling, si dhe në Kongresin e Unionit Evropian të Pingpongut (ETTU) në Zadar, Kroaci.

Bashkëpunimi rajonal dhe aktivitetet mbarëkombëtare

Gjatë vitit 2025, FPPK ka vazhduar bashkëpunimin me federatat e rajonit, veçanërisht me Federatën Shqiptare të Pingpongut si dhe Federatën e Pingpongut të Sllovenisë, duke realizuar aktivitete të përbashkëta garuese dhe takime zyrtare me fokus në shkëmbimin e përvojave, bashkëpunimin afatmesëm dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare, u zhvilluan takime bilaterale në Turqi me përfaqësues të federatave partnere, me ç'rast u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me Federatën e Pingpongut të Turqisë, e cila synon forcimin e bashkëpunimit sportiv, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e përbashkët të pingpongut në periudhën e ardhshme.

Partneritetet dhe marrëdhëniet institucionale

Federata e Pingpongut e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet sportive dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, duke siguruar mbështetje për organizimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e projekteve të ndryshme.

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin institucional me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kuadër të zbatimit të reformës ligjore dhe mbështetjes financiare për aktivitetet vjetore. Më 03.03.2025 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet FPPK-së dhe MKRS-së, me qëllim mbështetjen e realizimit të aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit.

Në kuadër të zhvillimit afatgjatë të infrastrukturës sportive dhe krijimit të kushteve më të mira për funksionimin e Federatës, gjatë muajit maj 2025 janë iniciuar procedurat nga Komuna e Fushë Kosovës për buxhetimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për ndërtimin e sallës dhe hapësirave të dedikuara për Federatën e Pingpongut të Kosovës në Fushë Kosovë.

Federata ka luajtur rol aktiv në lehtësimin e këtij procesi përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke kontribuar në avancimin e kësaj iniciative strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të sportit të pingpongut në vend.

Ky bashkëpunim ka reflektuar përkushtimin e Federatës për funksionim në përputhje me kornizën ligjore dhe për sigurimin e burimeve të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëdhëniet institucionale gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në forcimin e pozitës së Federatës së Pingpongut të Kosovës në strukturat ndërkombëtare, në hapjen e mundësive të reja për projekte zhvillimore dhe në avancimin e standardeve organizative.

Projekte inovative dhe qëndrueshmëria

Në drejtim të modernizimit institucional, gjatë vitit 2025 kanë filluar kontaktet fillestare lidhur me procesin e digjitalizimit të aktiviteteve dhe proceseve administrative të Federatës. Ky proces pritet të avancojë gjatë vitit 2026 dhe synon rritjen e efikasitetit organizativ, transparencës dhe menaxhimit më të strukturuar të aktiviteteve sportive.

Në shtator 2025, Federata e Pingpongut e Kosovës ka hapur thirrjen për pjesëmarrës në projektin inovativ të realizuar në kuadër të Open Lab Days, i mundësuar nga DYVÓLAB. Ky projekt ka për qëllim riciklimin e topave të pingpongut, duke i shndërruar ato në shpërblime simbolike për garat botërore WTT 2026.

Kjo iniciativë ka shënuar një hap të rëndësishëm drejt integritit të praktikave të qëndrueshme dhe elementeve të ekonomisë qarkore në aktivitetet sportive të Federatës, duke kombinuar inovacionin me promovimin e përgjegjësisë mjedisore.

FINANCIMI I AKTIVITETEVE

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut e Kosovës ka shënuar ngritje të të hyrave duke siguruar stabilitet të qëndrueshëm financiar, si dhe duke mundësuar realizimin e aktiviteteve të planifikuara kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe krijimin e një baze solide për vitet në vijim.

Burimet kryesore të financimit kanë përfshirë buxhetin publik të alokuar për sportin përmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), mbështetjen e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), fondet dhe programet zhvillimore të ITTF dhe ETTU, sponsorizimet dhe partneritetet me sektorin privat, projektet e financuara nga donatorë ndërkombëtarë, si dhe të hyrat nga organizimi i eventeve ndërkombëtare, në veçanti aktivitetet WTT të mbajtura në Kosovë.

Sipas Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin 2025, të hyrat totale kanë arritur 523,427.69 €, ndërsa shpenzimet 352,983.89 €, duke rezultuar me një tepriçë prej mbi 170,000 €. Kjo tepriçë lidhet kryesisht me organizimin e suksesshëm të aktiviteteve WTT.

Në fund të vitit 2025, gjendja në llogaritë bankare ishte 41,533 €, ndërsa llogaritë e arkëtueshme 56,750 €, që përfshijnë mjete nga MKRS dhe donacione nga sektori privat. Me realizimin e këtyre arkëtimeve, buxheti i bartur për vitin 2026 pritet të tejkalojë 98,000 €.

Llogaritë e pagueshme për vitin 2025 janë minimale dhe përfshijnë vetëm obligimet për kontribute dhe tatim në paga për muajin dhjetor. Në aspekt krahasues, federata ka kaluar nga një gjendje fillestare me borxhe rreth -78,000 € në fillim të vitit, në një gjendje pozitive financiare prej rreth +98,000 € në fund të vitit 2025, duke reflektuar menaxhim të përgjegjshëm financiar dhe disiplinë buxhetore.

Në përpjekje për të diversifikuar burimet financiare dhe për të zgjeruar bashkëpunimin me sektorin privat, gjatë vitit 2025 Federata është përballur me sfida në sigurimin e sponsorizimeve të reja.

Nga kontaktet e realizuara është theksuar se shumica e kompanive planifikojnë alokimet për sponsorizime në fund të vitit fiskal, ndërsa marrja e mandatit nga Bordi Ekzekutiv në fund të muajit janar ka kufizuar hapësirën kohore për krijimin e partneriteteve në fazat e hershme të vitit.

Megjithatë, Federata ka vazhduar zhvillimin e kontakteve gjatë gjithë vitit dhe aktualisht është në pritje të finalizimit të disa marrëveshjeve të reja sponsorizimi.

PËRFUNDIM

Gjatë vitit 2025, Federata e Pingpongut e Kosovës realizoi me sukses programin e saj vjetor, duke menaxhuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve që reflektojnë stabilitet organizativ, funksionim të rregullt të garave dhe rritje të kapaciteteve institucionale. Aktivitetet e zhvilluara përfshinë segmentet kryesore të veprimtarisë, përfshirë garat vendore dhe ndërkombëtare, pjesëmarrjen në aktivitete jashtë vendit, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe forcimin e qeverisjes së brendshme.

Organizimi i ngjarjeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në gara botërore, evropiane dhe rajonale rritën prezencën e Kosovës në kalendarin ndërkombëtar të pingpongut, ndërsa kalendarin e garave vendore siguroi vazhdimësi konkurruese dhe përfshirje të gjerë të sportistëve dhe klubeve.


Në aspektin institucional, viti 2025 u shënua nga ushtrimi i rregullt i qeverisjes, përfshirja e sportistëve në vendimmarrje dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përmes strukturave përfaqësuese dhe punëtorive konsultative.

Një zhvillim kyç ishte përgatitja e Strategjisë Zhvillimore 2025–2030, e hartuar përmes një procesi konsultativ, e cila vendos bazën për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të Federatës.

Në aspektin financiar, Federata përmirësoi ndjeshëm gjendjen buxhetore, duke kaluar nga një situatë me borxhe në fillim të vitit në një gjendje pozitive në fund të vitit 2025, si rezultat i menaxhimit të përgjegjshëm financiar.

Në përfundim, viti 2025 krijoi një bazë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të pingpongut në Kosovë, duke kombinuar aktivitetet sportive, forcimin institucional, stabilitetin financiar dhe orientimin strategjik për të ardhmen.

Me respekt,


Jeton Oruçi

Federata e Pingpongut e Kosovës
Kryetar

